

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2023

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	1.2.2023	Në shkollën 9 vjeçare X në Tiranë, shiten byrek në shkollë nga një zonjë qe nuk dihet se kur janë përgatitur, produktet që janë përdorur dhe as në çfarë kushtesh, e aq me tepër që nëse nuk shiten çfarë ndodh me to. Shpresoj shumë që ankesa ime të merret në konsideratë.	6.2.2023	Lidhur me ankesën mbi problematikat ne shkollën X me poshtë gjeni përgjigjen e Drejtorisë Rajonale te Autoritetit Kombëtar te Ushqimit, Qarku Tirane. Më datë 01.02.2023 trupa inspektuese e DRAKU Tirane, referuar indicjes se ardhur me e-mail , u paraqiten për verifikim ne ambientet përreth dhe brenda shkollës X në Tiranë, ku rezultoi se: Ne momentin e verifikimit ne ambientin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës, nuk u konstatua prezence e shitësve ambulante apo personave fizike, që tregtojnë produkte ushqimore. U kontaktua me drejtorin e shkollës z. Q.S i cili mohoi prezencën e ambulanteve apo personave fizike që tregtojnë rreth shkollës apo në oborrin e shkollës. Ai deklaroi që, objekti i shkollës është i survejuar me kamera dhe nuk është konstatuar një shqetësim i tille. Po ashtu, me datë 03.02.2023, DRAKU Tirane, me një trupe tjetër inspektuese kreu verifikime te tjera ne ambientet përreth dhe brenda shkollës X në Tiranë. Verifikimi u krye në bashkëpunim dhe me përfaqësues të Policisë Bashkiake ku rezultoi se: Ne momentin e verifikimit ne ambientin e jashtëm dhe te brendshëm të shkollës, nuk u konstatua prezence e shitësve ambulante apo personave fizike, qe tregtojnë produkte ushqimore sipas e-	E plotë	Nuk ka

2	9.3.2023	Kur u shtuan për herë të parë në Katalogu Kombëtar i Varieteteve, varietetet industrial kërpi Futura 75 dhe Santhika 27? Pse u hoqën varietetet nga publikimi i Prillit 2022 i Katalogut Kombëtar të Varieteteve?	10.3.2023	mailit bashkëngjitur. U kontaktua me rojën e institucionit i cili na mohoi prezencën e ambulateve apo personave fizike që tregtojnë rreth shkollës apo në oborrin e shkollës i cili na deklaroi se, objekti i shkollës është iurvejuar me kamera dhe nuk është konstatuar një shqetësim i tillë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nder të tjera është institucioni përgjegjës për kontrollin e importit dhe tregtimit të MMSHB (Materialit Mbjellës Shumëzues Bimorë). Ndër kriteret e importit, prodhimit dhe tregtimit të MMSHB-ve është edhe regjistrimi i tyre në Katalogun Kombëtar Të Specieve dhe Varieteteve në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu sqarojmë se, sa herë ka ndryshime dhe përditësime të Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve në vendin tonë, AKU njoftohet zyrtarisht nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve. Për më tepër, ju informojmë që institucioni përgjegjës për kryerjen e procedurave të regjistrimit etj. është Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve në Tiranë.	E plotë	Nuk ka
---	----------	---	-----------	---	---------	--------

3	10.3.2023	Organizata e shoqërisë civile Q.Q kërkon listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të institucionit.	15.3.2023	1. AA...VX 2. AA...VV 3. TR...L 4. AA...VV 5. AA...VV 6. AA...VV 7. TR...L 8. AA...VV 9. AA...VV 10. AA...VV 11. TR...R 12. AA...VV 13. AA...VX 14. AA...VV 15. TR...F 16. AA...XI 17. AA...VV 18. AA...VV 19. AA...VX 20. AA...XI 21. AA...VV 22. AA...XL 23. AA...VX 24. AA...XI 25. AA...PF 26. AA...XI 27. AA...VV 28. AA...VV 29. AA...NS 30. AA...VV 31. AA...VV 32. AA...VX 33. AA...VV 34. AA...VV 35. AA...XI 36. AA...XI 37. AA...VV 38. AA...VX 39. AA...VV 40. AA...VX 41. AA...VX	E plotë	Nuk ka
---	-----------	--	-----------	--	---------	--------

				42. AA...VV 43. AA...VX 44. AA...VX 45. AA...VV 46. AA...VV 47. AA...XI 48. AA...VV 49. AA...VV 50. AA...VV 51. AA...XI 52. AA...VV 53. AA...VV 54. AA...NS 55. AA...VV 56. AA...VV 57. AA...VX 58. AA...VX 59. AA...XI 60. AA...XI 61. AA...VX 62. AA...VV 63. AA...VV 64. AA...VV		
--	--	--	--	---	--	--

4	31.3.2023	Sa inspektime janë kryer nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në vitin 2023, 2022, 2021, 2020 dhe 2019? Inspektimet kanë qenë të planifikuara apo të rastësishme në varësi të situatave të ndryshme që janë krijuar kohë pas kohe (p.sh. zbulimi i produkteve të skaduara etj.)? Informacionit mbi inspektimet e kërkoj të detajuar sipas viteve dhe sipas qarqeve ku është kryer. Sa masa administrative janë vendosur nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në vitin 2023, 2022, 2021, 2020 dhe 2019? Të ndara sipas viteve dhe sipas shkeljeve që janë gjetur subjektet. Po ashtu të jenë të specifikuara sipas qarqeve dhe të jenë të identifikuar dhe përsëritësit. Nëse është e mundur kërkoj që të dërgohen bashkëngjitur dhe procesverbalët e kontrollove dhe ndëshkimeve. Sa prej masave administrative të vendosura në 5 vitet e fundit janë ekzekutuar nga ana juaj? Sa prej subjekteve të ndëshkuara janë ankuar në gjykatë dhe sa prej tyre kanë arritur që të fitojnë betejën me AKU? Sa ton ushqime janë sekuestruar dhe asgjësuar nga	14.4.2023	Kthim pergjigje Nr. 4 Aneksi 1 tabelat	E plote	Nuk ka
---	-----------	--	-----------	---	---------	--------

		AKU, për shkak se subjektet janë gjetur në shkelje të ndryshme si produkte të skaduara, të kontaminuara etj.? Gjatë inspektimeve të bëra në 5 vitet e fundit, a është konstatuar tregtimi i produkteve të skaduara, kontaminuara apo jashtë standardeve? A ka në tregun shqiptar produkte të rrezikshme për konsumatorët? Çfarë masash janë marrë? A keni marrë ankesa nga konsumatorë të cilët kanë blerë në subjekte të ndryshme produkte të skaduara, jashtë standardeve për tregtim apo të rrezikshme (p.sh. lodra për fëmijë? Çfarë masash janë marrë në këtë rast? A ka një strategji afatgjatë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për rritjen e sigurisë së produkteve ë tregtohen në vend, që konsumatorët të ndihen më të sigurt?				
--	--	---	--	--	--	--

5	14.4.2023	Shoqëria X është duke shqyrtuar mundësinë e eksportimit të produkteve të bulmetit drejt shtetit të Britanisë së Madhe. A duhet te ndjekim procedura specifike, të veçanta lidhur me kryerjen e eksportit drejt këtij shteti?	24.4.2023	Lidhur me kërkesën e subjektit për eksport të produkteve të bulmetit drejt shtetit të Britanisë së Madhe, ju bëjmë me dije se subjekti duhet ti drejtohet me kërkesë MBZHR për eksport drejt këtij shteti , ku gjithashtu duhet te përcaktoje edhe produktet për te cilat është i interesuar te eksportoje, kjo për arsye se nuk kemi një certifikate shëndeti te aprovuar me ketë shtet.	E plotë	Nuk ka
---	-----------	--	-----------	--	---------	--------

6	8.5.2023	Një kompani kërkon të eksportojë mishin e donerit në Shqipëri. Kërkon konfirmimin e “Leje Shëndetësore Veterinare Ndërkombëtare”.	16.5.2023	Certifikata te njohura midis autoriteteve kompetente te dy vendeve janë: -Urdhri nr. 120, date 06.03.2023 me lende "Për njohjen e modelit të certifikatës shëndetësore veterinare, për mish të shpendëve, me përjashtim të mishit të grirë dhe atij të ndarë mekanikisht për import nga Republika e Maqedonisë së Veriut për në Republikën e Shqipërisë". -Urdhri nr. 221, date 11.04.2023 "Për njohjen e modelit të certifikatës shëndetësore, për importin e mishit të freskët, përfshirë mishin e grirë dhe përgatitjet e mishit të kafshëve shtëpiakeve të gjedhit në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut. -Urdhri nr. 229, date 13.04.2023 "Për njohjen e modelit të certifikatës shëndetësore, për importin e mishit të freskët, përfshirë mishin e grirë dhe përgatitjet e mishit të kafshëve shtëpiakeve të dërrit në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut. -Urdhërin Nr. 346, datë 26.08.2021 "Për njohjen e certifikatës veterinare për mishin e freskët, duke përfshirë mishin e grirë të dhenve shtëpiake (Ovis Aries) dhe dhive shtëpiake (Capra Hircus) (Ovi), për eksport nga Republika e Maqedonisë se Veriut për në Republikën e Shqipërisë. Për fillim pa vonesë të njohjes dhe miratimit të kësaj model certifikate, ju lutem komunikoni me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për fillimin e procedurës.	E plotë	Nuk ka
---	----------	---	-----------	--	---------	--------

7	10.5.2023	Kompanitë që kanë të drejtën për të importuar vajin “Safflower Carthamus tinctorius” në Shqipëri. Kompanitë që kanë të drejtën për të përpunuar vajin “Safflower Carthamus tinctorius” në Shqipëri.	18.5.2023	Referuar Ligjit Nr.9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar, neni 14 "Importi" në pikat 1 dhe 2 citohet: "1. Ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi."; "2. Në rastin e marrëveshjeve të veçanta ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit eksportues, ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e përcaktuara në këto marrëveshje.". Gjithashtu nga informacioni i ardhur nga trupat inspektuese të AKU në Pikat e Inspektimit Kufitar nuk rezulton të jetë importuar Vaj "Safflower Carthamus Tinctorius" por vaj Sunflower. Të drejtën e përpunimit të produktit në fjalë por edhe të çdo produktit tjetër ushqimor e ka çdo operator i biznesit ushqimor (OBU) i cili ushtron aktivitetin e tij konform legjislacionit në fuqi, veçanërisht në fushën e ushqimit. Konkretisht referuar praktikave të mira të punës dhe të higjienës në vendin tonë ne lidhje me kushtet specifike dhe të veçanta që duhet të plotësojë një OBU këto janë detajuar ne paketën higjienike, përkatësisht në Udhëzimin e Ministrit Nr. 22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimorë”, përafruar kjo me legjislacionin European Reg CE 854/04. Qe një OBU të hapë një biznes në fushën e	E plotë	Nuk ka
---	-----------	--	-----------	--	---------	--------

				ushqimit është i detyruar që të kryej regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Subjektet që kryejnë aktivitet me pakicë nuk licencohen, pra nuk janë të detyruar të pajisen me licence në (QKB), por këto subjekte janë të detyruara të njoftojnë Drejtoritë Rajonale të AKU, për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë. Nëse subjekti kryen aktivitet me shumicë në fushën e ushqimit, (prodhim, përpunim e shpërndarje me shumice e ushqimeve për nënkategoritë II.1.A) është i detyruar që të bej kërkesën për regjistrim pranë QKB ku dhe detyrohet të paraqesë dokumentacionin përkatës. Theksojmë faktin se është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor që përgatit, përpunon, trajton, ruan, magazinon dhe shpërndan produkte ushqimore me pakicë apo shumicë, të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullat dhe standardet e detyrueshme tekniko teknologjike, në ambientet e tij, si dhe dokumentacion të rregullt të produkteve ushqimore kryesisht sipas këtij legjislacioni: Ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar; Udhëzimit Nr. 22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimorë”, Udhëzimit Nr. 20, datë 25.11.2010 “Për zbatimin e programeve		
--	--	--	--	--	--	--

				paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimentet ushqimore”.		
--	--	--	--	--	--	--

8	16.6.2023	Si aplikohet për miratim higjieno-sanitar për automjete, si dhe çfarë dokumentacioni kërkohet?	19.6.2023	Për sa i përket aplikimit për miratim higjieno-sanitar për automjete, aplikimi behet me anë të një kërkesë nga vete subjekti dhe bëhet në drejtorinë rajonale të AKU në qarkun ku subjekti ushtron aktivitetin e tij. Më pas trupa inspektuese e drejtorisë rajonale të AKU-së ushtron kontrollin me qëllimin verifikimin e kushteve higjieno-sanitare dhe tekniko-teknologjike të mjetit.	E plotë	Nuk ka
---	-----------	--	-----------	--	---------	--------

9	23.6.2023	1-Në prag të sezonit turistik veror ku janë fokusuar kontrollet në Qarkun e Korçës? 2- Sa kontrolle janë ushtruar gjatë vitit 2023 dhe cilat janë rezultatet e tyre në këtë qark? 3- Sa subjekte janë gjetur në shkelje, të çfarë natyre janë shkeljet dhe cilat janë masat e aplikuara ndaj tyre? 4- Sa është vlera e gjobave dhe a ka subjekte që u është pezulluar aktiviteti? 5- Sa kontrolle janë ushtruar në subjektet e llojit bare dhe restorante ne qytetin e Korçës dhe destinacionet turistike Dardhe, Voskopojë, Boboshticë, Pogradec dhe Pustec? 6- Sa kontrolle janë ushtruar në qarkun e Korçës me fokus prodhimin dhe tregtimin e pijeve alkoolike? 7- A ka pasur raste të gjetjes së shkeljeve në prodhimin dhe tregtimin e këtyre pijeve? Nëse po sa janë rastet dhe të çfarë natyre janë shkeljet? 8- A keni gjetur raste të prodhimit të pijeve alkoolike në rrugë ilegale në këtë qark dhe si keni vepruar në këto raste? 9- A është i përhapur fenomeni i prodhimit të pijeve alkoolike	4.7.2023	Kthim përgjigje nr. 9	E plotë	Nuk ka
---	-----------	--	----------	---------------------------------------	---------	--------

		në ambiente private të palicensuara në Qarkun e Korçës? C ‘farë masash janë marrë për reduktimin e rasteve? 10- A bëhen analiza laboratorike të pijeve alkoolike të sekuestruara që janë prodhuar në mënyrë të paligjshme dhe çfarë elemente kanë pasur në përbërje? 11.Cilat janë rreziqet që vijnë si pasojë e konsumit të këtyre pijeve që përmbajnë substanca të palejuara apo përqindje më të larta se normat?				
--	--	--	--	--	--	--

10	7.7.2023	Jam pjesë e një biznesi tregtie ushqimore, dhe jemi duke bashkëpunuar me një kompani shqiptare, me të cilën kemi bere disa marrëveshje për furnizim me mish viçi nga Brazili. Meqë është hera e parë që e bëjmë këtë bashkëpunim, nuk e dimë modelin e certifikatës shëndetësore që pranohet nga Autoriteti Shqiptar.	17.7.2023	Ne zbatim te Urdhrit Nr. 294 date 13.6.2006 Mbi importin e mishit nga Republika federale e Brazilit dhe marrëveshjen e arritur midis Autoriteteve veterinare qendrore te RSH dhe RFB lejohet importi i mishit te gjedhit prodhuar nga zona dhe stabilimente te miratuara nga BE shoqëruar me certifikatën e miratuar midis dy shteteve. Bashkëlidhur gjeni modelin e certifikatës si dhe Urdhrin Nr. 328, datë 22.11.2011 Për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hynë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve”. ku ka te përcaktuar shtetet nga te cilat lejohet importi i mishit te gjedhit.	E plotë	Nuk ka
----	----------	---	-----------	---	---------	--------

11	21.7.2023	1. Sa është numri i monitorimeve të kryera nga ana e AKU në rang vendi për tregtimin e PMB për vitin 2022 dhe vitin 2023? 2. Sa është numri i kontrolleve për qarkun e Korçës? 3. Cilat janë rezultatet e këtyre kontrolleve në rang vendi dhe për qarkun e Korçës? 4. Sa mostra janë marrë për analizë në qarkun e Korçës për periudhën 2022-2023 dhe cilat janë rezultatet e tyre? 5. A keni gjetur PMB që nuk lejohen të tregtohen në vendin tonë? Cilat janë ato dhe cili është impakti tek produktet bujqësore dhe në mjedis në rast përdorimi? 6. Sa është afati për kthimin e përgjigjeve të analizave nga ISUV dhe a arrin ky institucion t'i kthejë në kohë përgjigjet për rezultatet?	25.7.2023	Kthim përgjigje nr. 11	E plotë	Nuk ka
----	-----------	---	-----------	--	---------	--------

12	21.7.2023	1.A janë kryer inspektime nga AKU në tregun kryesor të Shkodrës, në lagjen Rus? 2.Nëse po, çfarë është konstatuar nga inspektimet e kryera? 3. Sa masa administrative janë marrë dhe për çfarë janë marrë këto masa administrative? 4. A i plotëson tregu në Rus (Shkodër) kushtet për tregtimin e produkteve?	27.7.2023	Tregu Rus është në administrimin e Bashkisë Shkodër dhe në treg operojnë tregtar ambulant si dhe një pjesë e tyre janë të pajisur me NIPT fermeri, gjë e cila AKU nuk mund të ushtrojë kontrolle zyrtare pasi nuk janë objekt inspektimi. Në ambientet e tregut Rus janë dhe OBU të cilët ushtrojnë aktivitet të pajisur me NIPT biznesi të cilët janë në data bazat tona të planifikuara për inspektim në bazë risku. Si rrjedhojë e pikës 1 vlen të theksohet se DRAKU Shkodër ka një bashkëpunim reciprok me ISHSH, NJVKSH dhe DRVHT, Policinë Bashkiake Shkodër si trupë mbështetëse mbi monitorimin e tregjeve. Masa administrative për Tregun Ushqimor Rus, Bashkia Shkodër nuk ka për vitin 2022-2023 por në vitin 2015 dhe në 2018 janë marrë masa administrative gjobë me vlerë 500.000(pesëqind mijë) lekë dhe 300.000 (treqind mijë) lekë.Për sa i përket OBU-ve që janë nën kontrollin e AKU-së i plotësojnë kushtet Higjiëno-Sanitare për tregtimin e produkteve ushqimore, ndërsa shitja që bëhet në trotuare apo në ambientet e tregut janë në administrim të Bashkisë Shkodër. Vlen të theksohet se në rastet kur AKU konstaton shkelje apo mangësi të kushteve Higjiëno-	E plotë	Nuk ka
----	-----------	--	-----------	---	---------	--------

13	2.8.2023	Listën e subjekteve të kallëzuara në prokurori nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për vitin 2015- 31 korrik 2023.	15.8.2023	Sanitare të tregtimit të produkteve ushqimore në mënyrë të menjëhershme dhe prioritare lajmëron dhe bashkëpunon me Instancat qe janë përgjegjëse për këto ambiente. Kthim përgjigje nr. 13	E plotë	Nuk ka
----	----------	---	-----------	---	---------	--------

14	2.8.2023	1. Listën e subjekteve të pezulluara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe afatin e pezullimit për secilin subjekt për vitin 2015- 31 korrik 2023. 2.Listën e subjekteve të gjobitura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe masën e gjobës për secilin subjekt për vitin 2015- 31 korrik 2023.	28.8.2023	Kthim përgjigje nr. 14	E plotë	Nuk ka
----	----------	--	-----------	--	---------	--------

15	22.8.2023	Dëshiroj të informohem nëse produkti i mëposhtëm, i cili prodhohet në Austri, lejohet të importohet dhe të shitet edhe në Shqipëri? Informacionet rreth produktit të cilin planifikoj ta importoj në Shqipëri: Përmbajtja sipas prodhuesit: Pije energjike, pije freskuese me kafeinë, me shije pjeshke-çaji-kërpi, ëmbëlsues (sukralozë, acesulfame K), përmbajtja e frutave 1%. Përbërësit: ujë, acidifikues, acid malik, laktat kaliumi, koncentrat i lëngut të pjeshkës, rregullues i aciditetit, citrat trikalium, aromë natyrale,	30.8.2023	Referuar legjislacionit me të cilin operon Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) konkretisht Ligjit Nr. 9863, date 28.1.2008 "Për Ushqimin" (i ndryshuar), Neni 3, pika 1, germa (e) përcakton Termi “ushqim” nuk përfshin: substancat narkotike dhe psikotrope, ku përfshihen produkte të cilat ju kërkoni të importoni. Për sa me sipër, këto produkte me arome kanabisi nuk lejohen të importohen dhe nuk i nënshtrohen kontrollit të inspektorit të AKU-se në Pikat e Inspektimit Kufitar.	E plotë	Nuk ka
----	-----------	--	-----------	---	---------	--------

16	24.8.2023	Kërkoj të më vini në dispozicion të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore funksionale të AKU-së në trajtë elektronike. Kërkoj informacion për aq sa ligji parashikon dhe mundëson për publikun në lidhje me ankesat e ardhura nga konsumator pranë AKU-së në ç'do formë (me shkresë dhe/ ose me e-mail) për muajin Qershor, Korrik dhe Gusht 2023 ku në informacionin e përcjellë të më niset brenda mundësive: 1. Emri dhe mbiemri i konsumatorit/ ankuesit dhe/ ose inicialet e emri dhe mbiemrit 2. Objekti i ankesës 3. Subjekti ndaj të cilit kryhet ankesa dhe/ ose inicialet e tij/ saj 4. Përfundimet e nxjerra/ përgjigja e dhëna nga AKU	4.9.2023	Kthim përgjigje nr. 16	E plotë	Nuk ka
17	25.8.2023	Kërkesë nr. 17	4.9.2023	Kthim përgjigje nr.17	E plotë	Nuk ka

18	29.8.2023	Duam te hapim një restorant në Tiranë dhe po shikoja procedurat e licencimit. Duke qenë që trajtohet si ushqim me pakicë nuk ka nevojë për licence me aq sa lexova ne faqe dhe lexova dhe kriteret më poshtë ku një nder to ishin dhe kushtet higjeno sanitare. Dokumenti për kushtet higjeno sanitare merret nga ju apo nga drejtoria e higjienës? Nëse ka ndonjë dokument që duhet aplikuar te AKU për ta marrë , mund të më thoni ju lutem?	7.9.2023	Në zbatim të Ligjit Nr. 54/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar” i ndryshuar, sqarojmë se plotësimi i kushteve dhe kërkesave ligjore higjieno-sanitare ndaj operatorëve të biznesit të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e ushqimit, i është atribuar si kompetencë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Për sa më lart, si pasojë e ndryshimeve të sipërcituara, theksojmë se verifikimi i zbatimit të kërkesave ligjore referuar kushteve higjieno-sanitare tashmë ezaurohet nga kontrollet zyrtare inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kërkesat ligjore në fuqi të cilat verifikohen në kuadër të procesit inspektues nga Drejtoritë Rajonale të AKU në çdo qark të vendit, janë ato të parashikuara në Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor” si dhe akte të tjera nënligjore referuar natyrës së aktivitetit specifik të subjektit. Gjithashtu,	E plotë	Nuk ka
----	-----------	--	----------	---	---------	--------

				subjektet që kryejnë aktivitet me pakicë janë të detyruara të njoftojnë Drejtorinë Rajonale të AKU në qarkun ku ushtron aktivitetin, për vendin e ushtrimit të aktivitetit dhe natyrën e tij, jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë në mënyrë që të programohet për kryerjen e një kontrolli zyrtar në periudhën në vazhdim për verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi gjatë të cilit bëhet edhe verifikimi i kushteve të përgjithshme higjieno-sanitare.		
--	--	--	--	---	--	--

19	8.9.2023	Në lidhje me produktet ushqimore qe tregtohen ne Shqipëri çfarë specifikon vendimi për etiketimin, produkti duhet të ketë vetëm datën e skadencës apo datën e prodhimit dhe të skadencës? Çfarë penaltetesh parashikon ligji në lidhje me produktet ushqimore data e sakdencës të së cilave nuk është e ‘pashlyeshme’ por hiqet lehtësisht ? Sa masa ka marrë AKU nga janari 2020 deri ne korrik 2023 për ato subjekte ose firma që hedhin në treg produkte data e skadences e të cilave fshihet?	15.9.2023	Kthim përgjigje nr. 19	E plotë	Nuk ka
----	----------	--	-----------	--	---------	--------

20	13.9.2023	Listën e subjekteve të kallëzuara në prokurori nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nga 1 Janar 2023 - 13 shtator 2023. Listën e subjekteve që janë gjobitura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nga 1 Janar 2023 - 13 shtator 2023. Listën e subjekteve që u është pezulluar aktiviteti nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nga 1 Janar 2023 - 13 shtator 2023.	27.9.2023	Kthim përgjigje nr. 20	E plotë	Nuk ka
----	-----------	--	-----------	--	---------	--------

